



A K T I T H E M E L U E S

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME EMERTIMIN

"ALGREC FOODS PROCESSING Co." Sh.p.k.



E lidhur sot me daten 07 Shkurt 1998 (nentedhjete e tete), ne TIRANE, personat si me poshte :

1 - Z. Agim Hasani, shetats shqiptar, i biri i Hasanit, lindur ne Kucove - Shqiperi ne vitin 11.03.1954 dhe banues ne Tirane (Shqiperi) ne Rruga Hil Mosi, nr. 3, me Pasaporte nr. NF Nr. 033268 ;

2 - Z. Ioannis Germanos, shtetas grek, i biri i Menealos, lindur ne Athine - Greqi ne 29.12.1943 dhe banues ne Athine - Greqi, me Pasaporte nr. K026182 ;

3 - Z. Viron Simonidis, shtetas grek, i biri i Ioaniss, lindur ne Stamboll - Turqi ne 19.11.1945 dhe banues ne Athine - Greqi, me Pasaporte nr. 401681285 ;

4 - Z. Dimitrios Ntinapogias, shtetas grek, i biri i Konstandinos, lindur ne Kalohori, Kalambaka - Greqi ne 30.10.1940 dhe banues ne Athine - Greqi, me Pasaporte nr. H830658 ;

dhe

5 - Znj. Aida Nani, shtetase shqiptare, e bija e Sifit, lindur ne Fier - Shqiperi ne 27.11.1973 dhe banuese ne Tirane - Shqiperi ne Rruga Hil Mosi nr.3. me Pasaporte nr. 0034700 ;

kane vendosur te themelojne dhe rregjistrojne nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas ligjit shqiptar me emerimin "ALGREC FOODS PROCESSING Co." Sh.p.k..

Neni 1 - EMERTIMI, QENDRA DHE AFATI I SHOQERISE

ORTAKET themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar te se drejtes shqiptare e cila me poshte do te quhet "SHOQERIA".

Percaktimet e hollesishme ne lidhje me qellimet dhe objektin e veprimtarise se SHOQERISE, menyren dhe rregullat per funksionimin e saj tregohen te plota dhe te lidhura me poshte ne kete AKT THEMELUES si edhe ne STATUTIN bashkengjitur.

Emertimi i plote i SHOQERISE do te jete : "ALGREC FOODS PROCESSING Co." Sh.p.k., ndersa emertimi i shkurtuar i SHOQERISE do te jete : "ALGREC" Sh.p.k. .

Qendra (selia) legale e SHOQERISE eshte ne qytetin e TIRANES ne adresen "Rruga Hil Mosi nr. 3".

Gjithashtu, me vendim te organeve te saj, Shoqeria mund te themeloje ose mbylle dege, perfaqesi dhe agjensi te saj brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

[Handwritten signatures]



Kohezgjatja e SHOQERISE fillon ditën e rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar dhe mbaron më 31 Dhjetor 2020.

Asambleja e Ortakeve në përputhje me mënyrën dhe procedurën e përcaktuar në dispozitat e STATUTIT të SHOQERISE mund të zgjatë ose të vendosë mbarimin e parakohshëm të SHOQERISE.

Neni 2 - NATYRA JURIDIKE DHE TREGTARE E SHOQERISE

SHOQERIA është person juridik privat i së drejtës shqiptare, veprimtaria e së cilës rregullohet nga ky AKT THEMELUES, STATUTI i saj bashkelidhur dhe legjislativi shqiptar.

SHOQERIA përgjigjet kundrejt të tretëve vetëm me pasuritë e saj dhe në asnjë rast nuk përgjigjet për detyrimet e marra përsiper nga vetë ORTAKET në person.

ORTAKET përgjigjen për detyrimet e SHOQERISE dhe përballojnë humbjet e saj deri në kufirin e vlerës nominale të kontributit të tyre pjesëmarrës në kapitalin themeltar të SHOQERISE.

SHOQERIA nuk përgjigjet për detyrimet e shtetit shqiptar dhe anasjelltas.

Neni 3 - OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Objekti i veprimtarisë së Shoqerisë është :

3.1. Kryerja e çdo lloji biznesi tregtar si importimin, eksportimin, tranzitimin, transportimin dhe tregtimin e mallrave të ndryshme me shumicë e pakicë në natyrën e lëndës së parë, produkteve të gatshme ose jo të tilla, makinerive e pajisjeve dhe, në veçanti por pa u kufizuar vetëm në të lidhur me:

- produkte me origjinë bujqësore, blegtorale dhe çfarëdo produkti tjetër ushqimor;
- frigorifere, lavatrice, pajisje ngrohëse dhe ftohëse, pajisje kompiuterike, televizore, hi-fi dhe të tjera produkte të kësaj natyre;
- mobileri dhe pajisje të tjera të përdorimit shtëpiak dhe të zyrave;
- çfarëdo lloji konfeksioni e veshje, pije të forta dhe të buta, duhan, cigare si edhe artikuj të tjera industriale;
- lëndë të para, materiale, pajisje, makineri dhe pjesë të këmbimit, teknologji dhe Know How;
- çfarëdo lloji tjetër malli që paraqet interes për Shoqerinë

3.2. SHOQERIA do të përmbushë dhe zhvillojë projekte investimi në çdo fushë të industrisë.

3.3. SHOQERIA ushtron veprimtari për dhënie të asistencës konsulencës në lidhje me çështje teknike, ligjore dhe të menaxhimit të business-eve dhe në veçanti në ato lloji veprimtarish që përmenden në këtë nen.



3.4. **SHOQERIA** do te ushtroje edhe veprimtarine te tejra si ndermjetesimi, factoring, komisioneri, perfaqesimi, brokerimi, agjensia me persona te tjere fizike apo juridike, publike apo private, vendas apo te huaj.

3.5. **SHOQERIA** do te marre pjese, ne interesin e saj me te mire, ne shoqeri te tjera te se drejtes shqiptare apo te shteteve te tjera si dhe te krijoje shoqeri te tjera tregtare me pale te treta si persona fizike apo juridike, publike apo private, vendas apo te huaj.

3.6. **SHOQERIA** mund te ushtroje veprimtari te tjera tregtare, marredhenie qiraje, shitblerje etj. lidhur me pasuri te luajtshme apo te paluajtshme, makineri dhe pajisje dhe gjithashtu, mund te kryeje cdo lloj veprimi tjeter finaciare, leasing, franchising, factoring etj. te quajtura te nevojshme dhe te dobishme ne interesin me te mire te **SHOQERISE**.

Neni 4 - KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i **SHOQERISE** ne castin e themelimit te saj eshte njeqinde mije mije (100.000.) Leke, sipas konfirmimit dhe certifikates bankare te leshuar ne kohen e depozitimit te tij nga Banka Tirana, Dega e Tiranes.

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar ne teresine e tyre dhe jane shlyer krejtesisht nga Ortaket ne te holla ne perputhje me procedurat ligjore

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte ndare ne njeqind (100) aksione. te numertuara nga nje (1) ne njeqind (100) duke patur nje vlere nominale Nje mije (1.000.) Leke secila.

Ortaket marrin pjese ne Kapitalin Themeltar dhe disponojne si pronare aksionet e tij ne modalitetet si vijon :

- Ortaku **AGIM HASANI**, merr pjese dhe disponon si pronar tridhjete per qind (30%) te Kapitalit Themeltar te Shoqerise duke i nenshkruar dhe shlyer teresisht tridhjete (30) Aksione te Kapitalit Themeltar, respektivisht Aksionet me numer Nje (1) deri ne Tridhjete (30) te cilat kane nje vlere nominale ne total Tridhjete mije (30.000.) Leke.

- Ortaku **IOANISS GERMANOS**, merr pjese dhe disponon si pronar tridhjete per qind (30%) te Kapitalit Themeltar te Shoqerise duke i nenshkruar dhe shlyer teresisht tridhjete (30) Aksione te Kapitalit Themeltar, respektivisht Aksionet me numer Tridhjete e nje (31) deri ne Gjashtedhjete (60) te cilat kane nje vlere nominale ne total Tridhjete mije (30.000.) Leke.

- Ortaku **VIRON SIMONIDIS**, merr pjese dhe disponon si pronar pesembedhjete per qind (15%) te Kapitalit Themeltar te Shoqerise duke i nenshkruar dhe shlyer teresisht pesembedhjete (15) Aksione te Kapitalit Themeltar, respektivisht Aksionet me numer Gjashtedhjete e nje (61) deri ne Shtatedhjete e pese (75) te

cilat kane nje vlere nominale ne total Pesembedhjete mije (15.000.) Leke.

- Ortaku DIMITRIOS NTINAPOGIAS, merr pjese dhe disponon si pronar pesembedhjete per qind (15%) te Kapitalit Themeltar te Shoqerise duke i nenshkruar dhe shlyer teresisht pesembedhjete (15) Aksione te Kapitalit Themetar, respektivisht Aksionet me numer Shtatedhjete e gjashte (76) deri ne Nentedhjete (90) te cilat kane nje vlere nominale ne total Pesembedhjete mije (15.000.) Leke.

- Ortaku AIDA NANI, merr pjese dhe disponon si pronar dhjete per qind (10%) te Kapitalit Themeltar te Shoqerise duke i nenshkruar dhe shlyer teresisht dhjete (10) Aksione te Kapitalit Themetar, respektivisht Aksionet me numer Nentedhjete e nje (91) deri ne Njeqind (100) te cilat kane nje vlere nominale ne total Dhjete mije (10.000.) Leke.

Kapitali themeltar i SHOQERISE mund te rritet nepermjet nenshkrimt te kuotave te reja dhe derdhjes se kontributeve ne te holla ose me ane te perfshirjes ne te, te vleftes se pasurive te paluajtshme ose te luajtshme te fituara ne menyra te ndryshme te ligjshme nga SHOQERIA. Vleresimi i tyre behet ne perputhje me nenin 42 te Ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare ".

Me Vendim te Asamblese se Ortakeve dhe me numrin e duhur te votave sipas dispozitave te ketij STATUTI dhe te ligjes mund te vendoset rritja ose zvogelimi i kapitalit themeltar.

Cdo veprim lidhur me kapitalin themeltar te SHOQERISE do te behet ne monedhe shqiptare.

Fondet ne te holla te ardhura nga shlyerja e pjeseve te kapitalit themeltar jane depozituar ne llogarine bankare te hapur ne emer dhe per llogari te SHOQERISE prane Banka Tirana, Dega e Tiranës.

Ne librin e llogarive te SHOQERISE rregjistrohet kapitali themeltar dhe detajohet kontributi i derdhur nga secili ORTAK.

Rregullat mbi transferimin e pjeseve apo gjithë kuotes se pjesmarrjes ne kapitalin themeltar jane parashikuar nga neni 9 i STATUTIT te SHOQERISE bashkengjitur.

Neni 5 - PERSONALITETI JURIDIK

SHOQERIA do te kete zotesi te fitoje te drejta dhe te marre persiper detyrime ne perputhje me dispozitat e ligjit dhe te akteve te Shoqerise te depozitura ne menyren e duhur ligjore ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se rrethit te TIRANES.

SHOQERIA do te filloje ushtrimin e veprimtarive te saj pas perfundimit te gjithë procedurave sipas ligjes dhe marrjes se autorizimeve te duhura per ushtrimin e atyre veprimtarive.

Neni 6 - VITI FINANCIAR

Viti financiar (ushtrimori) i SHOQERISE fillon ne 01 Janar dhe mbaron ne 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik.

Neni 7 - FITIMI I SHOQERISE

Destinacioni i fitimit neto te SHOQERISE, mbas zbritjes se cfaredo detyrimi fiskal ne perputhje me ligjin si edhe te shumave per fonde te ndryshme, percaktohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 8 - KOMPETENCE E ADMINISTRATOREVE

Administratori (et) i Shoqerise eshte i autorizuar te terheqie kapitalin themeltar te derdhur dhe depozituar duke paraqitur dokumentacionin e duhur (si Vendimi i gjykates per rregjistrimin e Shoqerise, certifikata e rregjistrimit tatimor, Akti Themelues dhe Statuti i Shoqerise) te cilat provojne themelimin dhe rregjistrimin e SHOQERISE sipas ligjes.

Neni 9 - ORGANET E SHOQERISE

Organet e SHOQERISE jane :

- 1 - Asambleja e Ortakeve;
- 2 - Administratoret.

Administrator i pare i Shoqerise ne castin e themelimit te saj eshte emeruar njeri prej Ortakeve, zoti AGIM HASANI.

Perberja, funksionet dhe kohezgjatja e ne pozite e Administratoreve te SHOQERISE percaktohen ne STATUTIN e saj.

Neni 10 - STATUSI LIGJOR I SHOQERISE

Shoqeria eshte themeluar dhe do te ushtroje veprimtarine e saj bazuar ne dispozitat e ketij Akti Themelues, te Statutit dhe te ligjit shqiptar ne pergjithesi.

Neni 11 - SHPENZIMET

Te gjitha shpenzimet lidhur me pergatitjen, nenshkrimin, depozitim dhe rregjistrimin sipas ligjes se Shoqerise dhe te dokumentacioni te saj ne Rregjistrin Tregtar do te perballohen nga Ortaket ne perputhje me raportin e pjesmarrjes se tyre ne Kapitalin themeltar te Shoqerise.

Neni 12 - MOSMARRVESHJET

Cfaredo mosmarreveshje lidhur me ceshte tregtare midis ORTAKEVE ose ORTAKEVE do te zgjidhet duke respektuar procedurat perkatese te arbitrazhit dhe mosmarreveshjeve tregtare te parashikuara ne Kodin Civil dhe, gjithashtu, ne Ligjin nr. 7632/04.11.1992 "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregtar", ne

Handwritten signatures and stamps at the bottom of the page, including a large signature on the left and several smaller ones on the right.

Ligjin 7638/19.11.1992 "Per Shoqerite tregtare", Ligjin 7667/28.01.1993 " Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite tregtare" dhe ligje te tjera ne fuqi ne Republiken e Shqiperise qe lidhen me marredheniet tregtare ne pergjithesi.

Neni 13 - DISPOZITE E FUNDIT


Ky Akt Themelues u hartua dhe shtyp ne gjuhen shqipe ne gjashte origjinale me 07 faqe secili. SHOQERIA mban tre nga origjinalet ndersa tre te tjerat depozitohen ne Rregjistrin Tregtar, prane noterit publik dhe ne Autoritetet tatimore.


ORTAKET pasi e lexuan, e kuptuan dhe e pranuan kete AKT THEMELUES, e nenshkruajne ate sot me daten 07 Shkurt 1998 ne prani te Noterit publik.

ORTAKET E SHOQERISE :




 Z. Agim Hasani






 Z. Viron Simonidis
 Viron Simonidis.




 Znj. Aida Nani







 Z. Ioannis Germanos





 Z. Dimitrios Ntinapogias



ΠΕΡΕΚΤΗΥΕ
 Ανδρεα Νουμου


REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 719....Rep

Tirane, me 07.02.1998

Nr. 72....Kol

V E R T E T I M

Ne Tirane sot me date 07.02.1998 (nentedhete e tete), para meje Noterit Gjylbere Pustina te Dhomes se Noterise Tirane u paraqiten personat si vijon :

1 - Z. Agim Hasani, shtetats shqiptar, i biri i Hasanit, lindur ne Kucove - Shqiperi ne vitin 11.03.1954 dhe banues ne Tirane (Shqiperi) ne Rruga Hil Mosi, nr. 3, me Pasaporte nr. MF Nr. 033269

2 - Z. Ioannis Germanos, shtetas grek, i biri i Menealos, lindur ne Athine - Greqi ne 29.12.1943 dhe banues ne Athine - Greqi, me Pasaporte nr. 4026192

3 - Z. Viron Simonidis, shtetas grek, i biri i Ioaniss, lindur ne Stamboll - Turqi ne 19.11.1945 dhe banues ne Athine - Greqi, me Pasaporte nr. 701681285

4 - Z. Dimitrios Ntinapogias, shtetas grek, i biri i Konstandinos, lindur ne Kalohori, Kalambaka - Greqi ne 30.10.1940 dhe banues ne Athine - Greqi, me Pasaporte nr. H 830658

dhe


5 - Znj. Aida Nani, shtetase shqiptare, e bija e Sifit, lindur ne Fier - Shqiperi ne 27.11.1973 dhe banuese ne Tirane - Shqiperi ne Rruga Hil Mosi nr.3. me Pasaporte nr. 0034700

Une Noteri publik u sigurova per identitetin e personave te lartpermendur dhe se ata jane madhore dhe permbushin kerkesat e ligjes per zotesine juridike dhe per te vepruar

Nre pranine e perkthyesit zyrtar Ardian Dvorani, te njohur zyrtarisht prej meje dhe te pranuar ne pranne time nga ana e shtetasve greke, personat e siperpermendur me kerkuan vertetimin sipas ligjes te ketij AKTI THEMELUES te Shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "ALGREC FOODS PROCESSING Co." Sh.p.k. dhe pasi, ne pranine time, e lexuan, e kuptuan, e pranuan dhe e nenshkruan, Une Noteri duke e gjetur kete veprim te rregullt dhe te mbeshtetur ne ligj e vertetoj dhe e nenshkruaj ate sipas ligjit.

N O T E R I

Gjylbere Pustina
Pustina





S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"ALGREC FOODS PROCESSING Co." Sh.p.k.

Shoqeria Tregtare "ALGREC FOODS PROCESSING Co." Sh.p.k. (e cila ketu me poshte quhet "SHOQERIA") eshte themeluar ne baze te AKTIT THEMELUES te nenshkruar (me poshte i quajtur " AKTI THEMELUES ") nga themeluesit e saj zoterinjte Agim Hasani, Ioaniss Germanos, Viron Simonidis, Dimitrios Ntinapogias dhe znj. Aida Nani.

ORTAKET jane marre vesh qe, pervec sa eshte parashikuar ne AKTIN THEMELUES, rregullat e marredhenieve dhe te veprimtarise se SHOQERISE do te parashikohen nga ky

STATUT i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin

" ALGREC FOODS PROCESSING Co." Sh.p.k.

T I T U L L I . 1

Emertimi - Vula - Qendra - Kohezgjatja - Objekti

Neni 1 - EMERTIMI I SHOQERISE

SHOQERIA do te kete emertimin e plote : " ALGREC FOODS PROCESSING Co." Sh.p.k. dhe emertimin e shkurtuar : " ALGREC".

Neni 2 - VULA DHE PUBLIKIMET E SHOQERISE

SHOQERIA ka VULEN e saj, permbajtja e se ciles do te jete si vijon: " ALGREC FOODS PROCESSING Co." Sh.p.k. ose "ALGREC" Sh.p.k..

Te gjitha aktet dhe dokumentat qe do te nxjerre SHOQERIA drejtuar te treteve ose publikut si p.sh. letra, fatura, njoftime e publikime te ndryshme duhet te tregojne qarte e lexueshem emertimin e SHOQERISE dhe pas tij fjalet "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" ose "sh.p.k." si dhe kapitalin e saj dhe emrin e Administratoreve te SHOQERISE.

Neni 3 - QENDRA E SHOQERISE - VENDBANIMI I ORTAKEVE

Qendra e SHOQERISE ndodhet ne TIRANE - SHQIPERI ne adresen Rruga Hil Mosi nr. 3.

SHOQERIA, me vendim te njerit prej organeve te saj mund te themeloje, transferoje ose mbylle agjensi, dege dhe perfaqesi ne lokalitete te tjera, si ne territorin e Republikes se Shqiperise ashtu edhe jashte tij.



Neni 4 - KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e SHOQERISE fillon ditën e regjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar dhe mbaron ditën e tridhjetë e një Dhjetorit të vitit 2020.

Neni 5 - OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Objekti i veprimtarisë së Shoqerisë është :

5.1. Kryerja e çdo lloj business tregtie si importimin, eksportimin, tranzitimin, transportimin dhe tregtimin e mallrave të ndryshme me shumice e pakice në natyrën e lëndës së parë, produkteve të gatshme ose jo të tilla, makinerive e pajisjeve dhe, në vecanti por pa u kufizuar vetëm në të lidhur me:

- produkte me origjinë bujqësore, blegtorale dhe çfarëdo produkti tjetër ushqimor;
- frigorifere, lavatrice, pajisje ngrohëse dhe ftohëse, televizore, hi-fi dhe të tjera produkte të kësaj natyre
- mobileri dhe pajisje të tjera të përdorimit shtëpiak dhe të zyrave;
- çfarëdo lloj konfeksioni e veshje, pije të forta dhe të buta, duhan, cigare si edhe artikuj të tjera industriale;
- lëndë të para, materiale, pajisje, makineri dhe pjesë të këmbimit, teknologji dhe Know How;
- çfarëdo lloj tjetër malli që paraqet interes për Shoqerinë

5.2. SHOQERIA do të përmbushë dhe zhvillojë projekte investimi në çdo fushë të industrisë.

5.3. SHOQERIA ushtron veprimtari për dhënie të asistencës konsulencës në lidhje me çështje teknike, ligjore dhe të menaxhimit të business-eve dhe në vecanti në ato lloj veprimtarish që përmenden në këtë nen.

5.4. SHOQERIA do të ushtrojë edhe veprimtari të tjera si ndërmjetësimi, factoring, komisioneri, përfaqësimi, brokerimi, agjensia me persona të tjera fizike apo juridike, publike apo private, vendas apo të huaj.

5.5. SHOQERIA do të marrë pjesë, në interesin e saj me të mirë, në shoqëri të tjera të së drejtës shqiptare apo të shteteve të tjera si dhe të krijojë shoqëri të tjera tregtare me pale të treta si persona fizike apo juridike, publike apo private, vendas apo të huaj.

5.6. SHOQERIA mund të ushtrojë veprimtari të tjera tregtare, marrëdhënie qiraje, shitblerje etj. lidhur me pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, makineri dhe pajisje dhe gjithashtu, mund të kryejë çdo lloj veprimi tjetër finaciare, leasing, franchising, factoring etj. të quajtura të nevojshme dhe të dobishme në interesin me të mirë të SHOQERISE.

Neni 6 - PERGJEGJESIA E SHOQERISE

SHOQERIA pergjigjet kundrejt te treteve vetem me pasurite e saj dhe, ne asnje rast, ajo nuk pergjigjet per detyrimet e marra persiper nga ORTAKET dhe as keta te fundit nuk perballojne detyrimet dhe humbjet e SHOQERISE pertej kufirit te vleftes se kuotes se pjesmarrjes se tyre ne kapitalin themeltar te saj.

SHOQERIA nuk pergjigjet per detyrimet e shtetit shqiptar dhe anasjelltas.

Neni 7 - CILESIA E ORTAKUT

Cilesia e ORTAKUT vetekupton cilesimin e qendres se SHOQERISE si adrese dhe vendodhje zyrtare te ORTAKUT si edhe pranimin pakushtezuar te dispozitave te AKTIT THEMELUES, te STATUTIT, te vendimeve te Asamblese se Ortakeve, edhe sikur dispozita te tilla te kene hyre ne fuqi perpara fitimit te cilesise se ORTAKUT.

T I T U L L I 2

Kapitali themeltar - Transferimi i pjeseve te tij

Neni 8 - KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i SHOQERISE ne castin e themelimit te saj eshte njeqinde mije mije (100.000.) Leke, sipas konfirmimit dhe certifikates bankare te leshuar ne kohen e depozitimit te tij nga Banka Tirana, Dega e Tiranës.





Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar ne teresine e tyre dhe jane shlyer krejtesisht nga Ortaket ne te holla ne perputhje me procedurat ligjore

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte ndare ne njeqind (100) aksione. te numertuara nga nje (1) ne njeqind (100) duke patur nje vlere nominale Nje mije (1.000.) Leke secila.

Ortaket marrin pjese ne Kapitalin Themeltar dhe disponojne si pronare aksionet e tij ne modalitetet si vijon :

- Ortaku AGIM HASANI, merr pjese dhe disponon si pronar tridhjete per qind (30%) te Kapitalit Themeltar te Shoqerise duke i nenshkruar dhe shlyer teresisht tridhjete (30) Aksione te Kapitalit Themeltar, respektivisht Aksionet me numer Nje (1) deri ne Tridhjete (30) te cilat kane nje vlere nominale ne total Tridhjete mije (30.000.) Leke.

- Ortaku IDANISS GERMANOS, merr pjese dhe disponon si pronar tridhjete per qind (30%) te Kapitalit Themeltar te Shoqerise duke i nenshkruar dhe shlyer teresisht tridhjete (30) Aksione te Kapitalit Themeltar, respektivisht Aksionet me numer Tridhjete e nje (31) deri ne Gjashtedhjete (60) te cilat kane nje vlere nominale ne total Tridhjete mije (30.000.) Leke.

- Ortaku VIRON SIMONIDIS, merr pjese dhe disponon si pronar pesembedhete per qind (15%) te Kapitalit themeltar te Shoqerise duke i nenshkruar dhe shlyer teresisht pesembedhete (15) Aksione te Kapitalit Themetar, respektivisht Aksionet me numer Gjashtedhete e nje (61) deri ne Shtatedhete e pese (75) te cilat kane nje vlere nominale ne total Pesembedhete mije (15.000.) Leke.

- Ortaku DIMITRIOS NTINAPOGIAS, merr pjese dhe disponon si pronar pesembedhete per qind (15%) te Kapitalit Themeltar te Shoqerise duke i nenshkruar dhe shlyer teresisht pesembedhete (15) Aksione te Kapitalit Themetar, respektivisht Aksionet me numer Shtatedhete e gjashte (76) deri ne Nentehdete (90) te cilat kane nje vlere nominale ne total Pesembedhete mije (15.000.) Leke.

- Ortaku AIDA NANI, merr pjese dhe disponon si pronar dhjete per qind (10%) te Kapitalit Themeltar te Shoqerise duke i nenshkruar dhe shlyer teresisht dhjete (10) Aksione te Kapitalit Themetar, respektivisht Aksionet me numer Nentehdete e nje (91) deri ne Njeqind (100) te cilat kane nje vlere nominale ne total Dhjete mije (10.000.) Leke.

Kapitali themeltar i SHOQERISE mund te rritet nepermjet nenskrimit te kuotave te reja dhe derdhjes se kontributeve ne te holla ose me ane te perfshirjes ne te, te vlefes se pasurive te paluajtshme ose te luajtshme te fituara ne menyra te ndryshme te ligjshme nga SHOQERIA. Vleresimi i tyre behet ne perputhje me nenin 42 te Ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare ".

Me Vendim te Asamblese se Ortakeve dhe me numrin e duhur te votave sipas dispozitave te ketij STATUTI dhe te ligjes mund te vendoset rritja ose zvogelimi i kapitalit themeltar.

Cdo veprim lidhur me kapitalin themeltar te SHOQERISE do te behet ne monedhe shqiptare.

Fondet ne te holla te ardhura nga shlyerja e pjeseve te kapitalit themeltar jane depozituar ne llogarine bankare te hapur ne emer dhe per llogari te SHOQERISE prane Banka Tirana, Dega e Tiranes.

Ne librin e llogarive te SHOQERISE rregjistrohet kapitali themeltar dhe detajohet kontributi i derdhur nga secili ORTAK.

Neni 9 - TRANSFERIMI I AKSIONEVE

Aksionet e pjesmarrjes ne kapitalin themeltar jane personale dhe lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie, ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve dhe ne rast te pjestimit te pasurise ndermjet bashkeshorteve.

Gjithashtu, Aksionet jane lirisht te transferueshme midis ortakeve pa ndonje kufizim apo procedure te vecante.



Ne rast te transferimit te kuotave nga ana e nje ORTAKU paleve te treta, ai eshte i detyruar te njoftoje ORTAKET e tjere nese ata do te ushtrojne te drejten e tyre te parablerjes se atyre aksioneve. Ne oferten e transferimit, e cila u behet e ditur te gjithe ORTAKEVE me leter rekomande, ORTAKU cedues duhet te tregojte cmimin e transferimit te aksioneve dhe emerit e bleresit te ardhshem.

ORTAKET, me Vendimin te Asamblese se Ortakeve, duhet te ushtrojne te drejten e parablerjes per te fituar ato kuota ose te njoftojne pranimin e transferimit te atyre kuotave pales se trete brenda tridhjetete diteve nga ajo e njoftimit si me siper. Ne rast te ushtrimit te se drejtes se parablerjes, ORTAKET i blejne kuotat qe cedohen sipas kriterit te proporcionit te pjesmarrjes se tyre ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

Ne rastin kur cmimi i kerkuar per transferimin e kuotave konsiderohet jo i drejte dhe i tepruar nga ORTAKET e tjere, keta te fundit duhet te kundershtojne ate vlere shitjeje brenda 30 (tridhjetete) diteve nga ajo e njoftimit dhe cmimi do te percaktohet nga nje ekspert ne baze te rezultateve te arritura ne bilancin e fundit te miratuar.

Transferimet e kryera paleve te trete pa respektuar kriteret e treguara me siper ne kete nen ose me nje cmim me te ulet nga ai i kerkuar nga ceduesi ORTAKEVE te tjere, jane te pavlefshme (nul) dhe nuk sjellin pasoje juridike kundrejt ORTAKEVE dhe SHOQERISE.

Neni 10 - OPERACIONET FINANCIARE

SHOQERIA ka te drejten e kerkimit dhe pranimit te burimeve te financimit apo kredive, huave etj. bga banka dhe institucione financiare.

Neni 11 - OPERIMET E SHOQERISE

SHOQERIA disponon dhe gezon pasurite e saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se saj.

SHOQERIA ka te drejten e blerjes dhe administrimit te pasurive te cdo lloji e natyre si dhe te jape garanci, bond-e mbi pasurite e saj per te permbushur detyrime te saj te marra persiper kundrejt paleve te treta.

T I T U L L I 3

Financat e SHOQERISE - Bilanci

Neni 12 - BILANCI DHE FONDET E SHOQERISE

SHOQERIA per ushtrimin e aktivitetit te saj krijon fondet e nevojshme si dhe fondin rezerve e fonde per zhvillim. Perberja, madhesia e tyre, burimet e krijimit, perdorimi e rregullimi i cdo fondi te vecante ne perputhje me rrethanat, interesat dhe objektin e veprimtarise se SHOQERISE, vendosen nga Asamblea e Ortakeve dhe Administratort e SHOQERISE.

SHOQERIA disponon mjetet e saj financiare. Te gjitha detyrimet e mundshme gjate veprimtarise se SHOQERISE do te perballohen nga fondet perkatese apo fonde rezerve ose, si alternative, me ane te zmadhimit ose zvogelimit te kapitalit themeltar. Te gjitha llogarit e SHOQERISE pasqyrohen ne bilancin e saj me vlefte te rehur ne monedhe shqiptare.

Bilanci dhe llogarit e SHOQERISE perpilohen nga Administratoret e SHOQERISE sipas rregullave mbi bilancin e kontabilitetin e shoqerive tregtare te legjislacionit financiar shqiptar.

Viti financiar (ushtrimori) fillon me daten 1 Janar dhe mbaron me daten 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik.

Bilanci vjetor zyrtar detyrimisht i paraqitet Asamblese se Ortakeve brenda tre muajve nga data e mbarimit te cdo viti financiar.

Ne perfundim te cdo viti financiar, Administratoret marrin masat e duhura per pergatitjen dhe perfundimin e bilancit te SHOQERISE, bazuar ne kriteret e perzgjedhura me kujdesin maksimal duke respektuar dispozitat ligjore mbi bilancin dhe kontabilitetin e shoqerive tregtare te legjislacionit shqiptar. Bilancit te SHOQERISE i bashkengjitet nje relacion permbledhes mbi veprimtarine e zhvilluar nga SHOQERIA gjate atij viti financiar.

Bilanci dhe relacioni i veprimtarise se SHOQERISE i paraqiten per miratim Asamblese se Ortakeve.

Neni 13 - SHPERNDARJA E FITIMIT

Destinacioni i fitimit neto i cili rezulton pas zbritjes se shumave per cfaredo detyrime fiskal ne perputhje me ligjen si edhe te shumave per celjen e fondeve te tjera te nevojshme, do te percaktohet me Vendim te Asamblese se Ortakeve.

F I T U L L I 4

Asambleja e Ortakeve - Administrimi i SHOQERISE

Neni 14 - ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Te gjitha fuqite dhe kompetencat qe ligji shqiptar dhe praktika lokale dhe nderkombetare i njej Asamblese se Ortakeve do te ushtrohen nga Ortaket ne Mbledhjet e Asamblese se tyre gjithmone duke respektuar ligjin. Aktin Themelues dhe Statutin e Shoqerise.

Neni 15 - MBLEDHJE TE ZAKONSHME DHE TE JASHTEZAKONSHME

Asambleja e Ortakeve zhvillon Mbledhje te zakonshme dhe te jashtezakonshme dhe ne menyre te posacme por pa u kufizuar vetem ne to, vendos lidhur me ceshtjet vijuese :

- 1 - per miratimin e bilancit vjetor dhe te politikës se ardhshme te veprimtarise se SHOQERISE;

- 2 -- per emerimin e Administratoreve ;
- 3 -- per destinacionin e fitimit neto te realizuar;
- 4 -- per ndryshimin e dispozitave te STATUTIT dhe te AKTIT THEMELUES;
- 5 -- per zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit themeltar te SHOQERISE;
- per zgjatjen, ose prishjen e parakohshme te SHOQERISE ose ndryshimin e formes se saj;
- per emerimin e likujduesit ose likujduesve dhe percaktimin e te drejtave dhe kompetencave te tyre :

Vendimet ne lidhje me pikat 4, 5 dhe 6 mesiper do te merren vetem ne Mbledhjet e Jashtezakonshme te Asamblese se Ortakeve.

Mbledhja e Zakonshme e Asamblese se Ortakeve merr vendime me shumicen e votave te Ortakeve te pranishem dhe vendimet jane te vlefshme kur per to kane votuar Ortaket qe disponojne se paku pesedhjete plus nje per qind te aksioneve te Kapitalit Themeltar.

Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Ortakeve merr vendime me shumicen e votave te Ortakeve te pranishem dhe vendimet jane te vlefshme kur per to kane votuar Ortaket qe disponojne se paku shtatedhjete e pese per qind te aksioneve te Kapitalit Themeltar.

Ne rast barazie votash vendos ajo e e Kryetarit te Mbledhjes se Asamblese se Ortakeve.

Neni 16 - MBLEDHJA E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asamblea e Ortakeve, e cila mund te mblidhet, ne qendren e SHOQERISE ose jashte saj, si brenda ashtu edhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise, thirret se paku nje here ne vit, por jo me vone se 3 (tre) muaj nga perfundimi i vitit financiar mbas njoftimeve me shkrim te cilat u dergohen cdo ORTAKU 15 (pesembedhjete) dite perpara dates se mbledhjes, me leter rekomande me lajmerim marrje, ne adresen me te fundit te secilit ORTAK te treguar ne LIBRIN E ORTAKEVE.

Njoftimi me shkrim i siperpermendur, per te qene i vlefshem detyrimisht duhet te tregoje daten, vendin dhe oren e thirrjes, rendin e dites me specifikimet perkatese lidhur me ceshtjet qe do te shqyrtohen. Ceshtjet qe nuk tregohen ne rendin e dites nuk mund te shqyrtohen pervec se me marreveshje unanime te ORTAKEVE te pranishem me kushtin qe te perfaqesojne se paku tre te katertat e kapitalit themeltar te SHOQERISE.

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve drejtohet nga Ortaku qe zoteron shumicen relative te Aksioneve te Kapitalit Themeltar dhe ne rast se ka me shume se nje te tille, nga me i moshuari prej tyre.

Te drejten e votes e kane ORTAKET qe jane rregjistruar ne LIBRIN E ORTAKEVE se paku 5 (pese) dite perpara mbledhjes se Asamblese se Ortakeve.

Secili ORTAK ka te drejten e nje numri votash korresponduese per

cdo pjese (kuote) qe ai zoteron ne kapitalin themeltar dhe mund te delegoje me shkrim per te marre pjese ne Mbledhjen e Asamblese nje person tjetër qofte edhe jo ORTAK.

Kryetarit te Asamblese se Ortakeve i takon kompetenca te konstatoje te drejten per te marre pjese dhe diskutuar ne mbledhjen e Asamblese se Ortakeve.

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve eshte e vlefshme pa u respektuar formalitetet e thirrjes te treguara me sipër ne kete STATUT atehere kur do te jete i perfaqesuar ne ate mbledhje i gjithë kapitali themeltar i SHOQERISE.

Neni 17 - ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Administrimi i SHOQERISE i besohet nje ose me shume Administratoreve te emeruar nga Asamblea e Ortakeve. Administratorët qendrojnë ne kete funksion per nje periudhe qe Asamblea e Ortakeve e percakton ne aktin e emerimit, pervec rasteve te doreheqjes ose te revokimit ne cfaredo kohe nga po ajo Asamble.

Neni 18 - KOMPETENCA TE ADMINISTRATOREVE

Administratorët veprojnë me fuqite dhe kompetencat e pakufizuara lidhur me drejtimin e SHOQERISE ne perputhje me qellimet dhe objektin e veprimtarise se SHOQERISE, me perjashtim te atyre qe ne baze te ligjit, AKTIT THEMELUES, STATUTIT i takojne ne menyre taksative dhe eksklusive Asamblese se Ortakeve.

Administratoreve, bashkerisht ose vec e vec, dhe ne perputhje me kompetencat e tyre te percaktura ne aktin e emerimit u takojne ne menyre te vecante kompetencat si vijon :

- 1 - te vene ne zbatim vendimet e Asamblese se Ortakeve;
- 2 - te manaxhojne ne vazhdimesi veprimtarite e Shoqerise;
- 3 - te administrojne pasurite e SHOQERISE, ne interesin me te mire te saj dhe ne perputhje me dispozitat e Aktit Themelues, Statutit dhe me Vendimet e Asamblese se Ortakeve;
- 4 - te drejtojne dhe te mbikqyrin veprimtarine e degeve, agjensive, perfaqesive etj., te themeluara nga SHOQERIA.
- 5 - te lidhin kontrata te cfardo lloji e natyre ne emer dhe per llogari te SHOQERISE.
- 6 - te celin, mbyllin ose transferojne llogari bankare te Shoqerise dhe gjithashtu te depozitojne, terheqin ose transferojne masa monetare ne ose nga ato llogari bankare;
- 7 - te punesojne ose largojne nga puna cdo anetar te staff-it punonjes te saj.

Administratorët, bashkerisht ose vec e vec, jane pergjegjes ndaj SHOQERISE per detyrimet qe jane brenda kompetences se tyre eksklusive.



Neni 18 - PERFAQESIMI DHE FIRMA E SHOQERISE

Te drejten e Firmes dhe te perfaqesimit te SHOQERISE perpara te treteve e kane nje ose me shume Administratore te SHOQERISE. Ne castin e themelimit te saj Shoqeria emerone si Administrator te saj njerin prej Ortakeve, zotin AGIM HASANI.

Administratoret, rast pas rasti, kane te drejte te delegojne te drejten e firmes dhe perfaqesimit, duke emeruar nje ose me shume persona por atyre u ndalohet t'u lesojne atyre prokura apo

autorizime per delegime te pergjithshme dhe te pakufizuar te kompetencave.

Neni 19 - KONTROLLI I FINANCIAR

Per kontrollin e veprimtarise financiare te SHOQERISE, Asambleja e Ortakeve emerone nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar. Ne castin e themelimit te saj, emerohet ekspert kontabel i autorizuar i Shoqerise zoti Kosta Nika.

Keta eksperte kontabel, emerohen per cdo dy vjet ushtrimore dhe jane te riemerueshem. Ndalohet qe te emerohen si Eksperte kontabel te autorizuar punonjes te SHOQERISE ose te agjensive, perfaqesive etj. te saj.

Neni 20 - MARREDHENIET E PUNES

Marredheniet e punes ndermjet SHOQERISE, degeve, agjensive ose zyrove te perfaqesimit te saj dhe punonjesve te tyre rregullohen me kontraten e punes te redaktuara ne perputhje me ligjin shqiptar apo te vendit ku ndodhet dega, perfaqesia, agjencia etj.

T I T U L L I 5

Mbarimi - Prishja - Likuidimi

Neni 21 - PRISHJA E SHOQERISE

SHOQERIA priset ne rastet kur ;

- 1 - mbaron afati i parashikuar ne AKTIN THEMELUES dhe STATUT;
- 2 - nuk mund te realizohet objekti i SHOQERISE sipas AKTIT THEMELUES dhe STATUTIT;
- 3 - nje vendim te tille e merr Asambleja e Ortakeve;
- 4 - ne rastet e parashikuara ne ligj.

Neni 22 - LIKUIDIMI I SHOQERISE

Ne rast te prishjes se SHOQERISE per cfaredo arsye, likuidimi i Shoqerise behet nga nje ose disa likuidatore te emeruar nga Asambleja e Ortakeve.

Likuidimi i SHOQERISE do te behet sipas dispozitave te ligjit shqiptar ne fuqi ne castin e likuidimit.

Asambleja e Ortakeve vendos rregullat per proceduren e likuidimit, kompetencat e shperblimin e likuidatoreve dhe ceshtje te tjera te tij.

Ne perfundim te procedurave te likuidimit pasuria neto e SHOQERISE i mbetet ORTAKEVE.

Neni 23 - MBARIMI I DEGEVE

Mbarimi i veprimtarise se DEGEVE, perfaqesive agjensive etj. vendoset nga Asambleja e Ortakeve.

Likujdimi i tyre kur jane vendosur jashte shtetit rregullohet nga legjislacioni i shtetit ne te cilin jane vendosur.

T I T U L L I 6 D I S P O Z I T A T E F U N D I T

Neni 24 - STATUSI LIGJOR I SHOQERISE

Shoqeria eshte themeluar dhe do te ushtroje veprimtarine e saj bazuar ne dispozitat e ketij STATUTI, te Aktit Themelues dhe te ligjit shqiptar ne pergjithesi.

Neni 25 - SHPENZIMET


Te gjitha shpenzimet lidhur me pergatitjen, nenshkrimin, depozitimimin dhe rregjistrimin sipas ligjes se Shoqerise dhe te dokumentacioni te saj ne Rregjistrin Tregtar do te perballohen nga Ortaket ne perputhje me raportin e pjesmarrjes se tyre ne Kapitalin themeltar te Shoqerise.

Neni 26 - MOSMARRVESHJET

Cfaredo mosmarreveshje lidhur me ceshte tregtare midis ORTAKEVE ose ORTAKEVE do te zgjidhet duke respektuar procedurat perkatese te arbitrazhit dhe mosmarreveshjeve tregtare te parashikuara ne Kodin Civil dhe, gjithashtu, ne Ligjin nr. 7632/04.11.1992 "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregtar", ne Ligjin 7638/19.11.1992 "Per Shoqerite tregtare", Ligjin 7667/28.01.1993 " Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite tregtare" dhe ligje te tjera ne fuqi ne Republiken e Shqiperise qe lidhen me marredheniet tregtare ne pergjithesi.

Neni 27 - DISPOZITE E FUNDIT

Ky STATUT u hartua dhe shtyp ne gjuhen shqipe ne shtate origjinale me 11 faqe secili. SHOQERIA mban kater nga origjinalet



ndersa tre te tjerat depozitohen ne Rregjistrin Tregtar, prane noterit publik dhe ne Autoritetet tatimore.

ORTAKET pasi e lexuan, e kuptuan dhe e pranuan kete STATUT, e nenshkruajne ate sot me daten 07 Shkurt 1998 ne prani te Noterit publik.

ORTAKET E SHOQERISE:

Agim Hasani

Z. Agim Hasani

Agim Hasani

Viron Simonidis

Z. Viron Simonidis

Viron Simonidis

Aida Nani

Znj. Aida Nani

Aida Nani

Ioannis Germanos

Z. Ioannis Germanos

Ioannis Germanos

Dimitrios Ntinapogias

Z. Dimitrios Ntinapogias

Dimitrios Ntinapogias

*ΠΕΚΕΤΑΡΟΣ
Αυλίας
10/9/98*



REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 720...Rep

Tirane, me 07.02.1998

Nr. 73...Kol

V E R I T E T I M

Në Tirane sot me date 07.02.1998 (nentedhjeta e tete), para meje Noterit Gjyltere Pashina te Dhomes se Noterise Tirane u paraqiten personat si vijon :

1 - Z. Agim Hasani, shtetats shqiptar, i biri i Hasanit, lindur ne Kucove - Shqiperi ne vitin 11.03.1954 dhe banues ne Tirane (Shqiperi) ne Rruga Hil Mosi, nr. 3, me Pasaporte nr. MF Nr. 033268;

2 - Z. Ioannis Germanos, shtetas grek, i biri i Menealos, lindur ne Athine - Greqi ne 29.12.1941 dhe banues ne Athine - Greqi, me Pasaporte nr. K 02619

3 - Z. Viron Simonidis, shtetas grek, i biri i Ioaniss, lindur ne Stamboll - Turqi ne 19.11.1945 dhe banues ne Athine - Greqi, me Pasaporte nr. K 01681285

4 - Z. Dimitrios Ntinapogias, shtetas grek, i biri i Konstandinos, lindur ne Kalohori, Kalambaka - Greqi ne 30.10.1940 dhe banues ne Athine - Greqi, me Pasaporte nr. H 830658;

dhe

5 - Znj. Aida Nani, shtetase shqiptare, e bija e Sifit, lindur ne Fier - Shqiperi ne 27.11.1973 dhe banuese ne Tirane - Shqiperi ne Rruga Hil Mosi nr.3, me Pasaporte nr. 0034700;

Une Noteri publik u sigurova per identitetin e personave te lartpermendur dhe se ata jane madhore dhe permbushin kerkesat e ligjes per zotesine juridike dhe per te vepruar

Ne pranine e perkthyesit zyrtar Ardian Dvorani, te njohur zyrtarisht prej meje dhe te pranuar ne pranne time nga ana e shtetasve greke, personat e siperpermendur me kerkuan vertetimin sipas ligjes te ketij STATUTI te Shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "ALGREC FOODS PROCESSING Co." Sh.p.k. dhe pasi, ne pranine time, e lexuan, e kuptuan, e pranuan dhe e nenshkruan, Une Noteri duke e gjetur kete veprim te rregullt dhe te mbeshtetur ne ligj e vertetoj dhe e nenshkruaj ate sipas ligjit.

N O T E R I

Gjyltere Pashina
